



**PROJEKT ZBATIMI I RRUGES  
URA E LLIXHAVE-BANJE BUNJISHT  
BASHKIA DIBER**

**RELACIONI TEKNIK**

*Pergatiti:*

*“STUDIO E.B.S” shpk:*

*Ing. Anderson Simoni*

*Ing. Esmeralda Halili*

*Porosites:*

*Bashkia Diber*

*TIRANE ,2019*

## PERMBAJTJA

<b>1</b>	<b>TE PERGJITHSHME .....</b>	<b>3</b>
1.1	ZONA E PROJEKTIT.....	3
<b>2</b>	<b>PERSHKRIMI PUNIMEVE TE PROJEKTIT.....</b>	<b>3</b>
2.1	NGRITJE KANTIERI .....	3
2.2	PUNIME GERMIMI DHE SHTRESASH.....	4
2.3	PUNIME VEPRRA ARTI, URA, KANALE DHE MURE MBAJTES.....	4
2.4	SINJALISTIKA .....	5
<b>3</b>	<b>SHPRONESIMET .....</b>	<b>5</b>
<b>4</b>	<b>ORGANIZIMI I PUNIMEVE .....</b>	<b>6</b>

# 1 TE PERGJITHSHME

## 1.1 ZONA E PROJEKTIT

Objekti i projekt zbatimit, rruga Ura e Llixhave-Banje Bunjisht, ndodhet ne fshatin Staravec, Qarku Diber. Ruga lidhet me infrastrukturen egzistuese qe lidh qytetin e Peshkopise me komunen Tomin dhe fshatrat e saj ne pjesen veriperendimore ,pikerisht me fshatin Staravec dhe do te kete nje gjatesi totale rreth 415 m.




Fig.1 Zona e zhvillimit te projektit

## 2 PERSHKRIMI PUNIMEVE TE PROJEKTIT

Grupi i projektimit gjate hartimit te ketij projekt-zbatimi ka kryer rikonicionin ne vend te gjendjes si dhe matjet e plota topografike. Nje pjese e trasese se rruges eshte egzistuese por shume e demtuar, ndersa nje pjese e saj do te hapet e re. Gjate studimit u moren parasysh kushtet e terrenit ku kalon rruga si dhe kerkesat e detyres se projektimit. Rruga do te kete nje gjeresi mesatare rreth 5 m, prej te cilave 4 m asfaltim dhe 50 cm kunete betoni.

### 2.1 NGRITJE KANTIERI

Projekti i zbatimit per rrugen Ura e Llixhave-Banje Bunjisht do te filloje me ngritjen e kantierit qe do te vendoset ne nje shesh te pershtatshem pergjate aksit te rruges qe do te ndertohtet. Nje strukture prej duralumini do te sherbeje si ambjent zyre per mbajtjen e dokumentacionit dhe materialeve te tjera qe mund te nevojiten gjate kryerjes se punimeve.

## 2.2 PUNIME GERMIMI DHE SHTRRESASH

Projekti parashikon rikonstrukcion ,ndertim dhe asfaltimin komplet te rruges prej 415 m.

Rikonstrukcioni i rruges eshte projektuar me gjeresi te vijes se kalimit te asfaltuar 5 ml.Jane mare masa per largimin e plote te ujrave duke vendosur pusetat e grumbullimit te ujrave sipërfaqesore e si: kunetat e betonit dhe tubat e shkarkimit me tubo te brinjezuar  $\varnothing 300$  mm .Ne funksion te qarkullimit te autojeteve ne kete aks, bazamentet ku kalon rruga dhe matrialeve te ndertimit qe do te perdoren, jane percaktuar shtresat e rruges per te cilat jepen ne profilat terthore tip, te materialit grafik.

Per kategorine e projektimit qe ka rruga (sipas detyres se projektimit), numri maksimal i mjeteve qe parashikohet te kalojne ne to eshte rreth 600 mjete njesi ne dite,(ne periudhen e pikut) me perspektive per 20 vjet, me ritje mesatare vjetore prej rreth 4 %. Per kete numur mjtesh jane percaktuar shtresat rrugore. Gjithashtu ne rruget ekzistuese do te behet plotesimi i shtresave ekzistuese me shtresat e tjera te nevojeshme.

Shtresat e parashikuara ne projekt jane:

L=415 m

t=30 cm shtrese zhavor lumi me cilindrim

t=10 cm shtrese stabilizanti

t $\geq$  4cm shtrese asfaltobeton




Fig.2 Profili tip i rruges

## 2.3 PUNIME VEPRA ARTI,URA,KANALE DHE MURE MBAJTES

Gjate ndertimit te rruges do te ndertohet nje ure me lartesi Hd=5m.

Ballnat e ures rekomandohen te ndertohen me mur me llac cemento m.50 ndersa jasteket prej betoni 30-40 cm te M.200.Nga progresivi 0+000 ÷ 0+125 m nga njera ane e rruges do te ndertohet mur mbajtes rreth 2m i larte,ndersa gjate gjithë segmentit te rruges do te ndertohet sistemi i kullimit te ujerave te shiut ne njeren ane te rruges.Ai do te perbehet nga kunete betoni C20/25.Kuneta do te kete 0.5 m dhe pjerresi terthore 10%.Ne cdo 24-28 ml do ndertohen puseta me beton C20/25dhe parete 15 cm.Kapaket e pusetave do jene gize( me menteshe)dhe te prodhuar per ngarkesa te renda.Lidhja midis pusetave do behet me tuba PE te brinjuar me diameter D=300 te vendosura poshte pusetave.Tubat do te vendosen mbi nje shtrese rere 10cm dhe do te mbulohen po me rere deri ne 10 cm mbi kuroren e tubit.

## **2.4 SINJALISTIKA**

Ne perfundim te punimve do te fillohet me vendosjen e sinjalistikes sipas standarteve te vendosura nga autoriteti rrugor shqiptar. Ne projekt-Preventivin e sinjalistikes eshte parashikuar sinjalistika horizontale dhe ajo vertikale. Rruga eshte trajtuar si rruge me dy sense levizjeje. Kjo ben te mundur levizjen lirshem te qarkullimit.

### **Sinjalistika horizontale do te perbehet:**

- Ne te gjitha rrugen do te behet vijezi. Vijezi perbehet nga dy vija te pandrprera te vendosura respektivisht ne te dy anet e rruges ne fund te asfaltit me gjeresi 10 cm dhe nje vije e nderprere ne ndarjen e korsive.
- Shigjetat e drejtimit te levizjes. Ato do te vendosen ne cdo korsi per te bere nje orientim sa me te mire te levizjes se mjeteve.

### **Sinjalistika Vertikale do te perbehet nga tabelat:**

- Tabelat Detyruese
- Tabelat Treguese
- Tabelat Pralajmeruese

Te gjitha tabelat do te vendosen ne ante te trotuarit dhe do te fiksohen me beton M-250.

## **3 SHPRONESIMET**

Ne aksin ku do te kaloje rruga nuk do te kete shpronesime pasi nje pjese e trasese eshte egzistuese ndersa pjesa tjeter eshte toke shteterore.

#### **4 ORGANIZIMI I PUNIMEVE**

Metodologjia dhe radha e kryerjes se punimeve do te jete gjithnje ne zbatim te vizatimeve te projektit,matjeve topografike te realizuara ne fillimin e punimeve,specifikimet teknike dhe ne zerat e percaktuara ne listen e preventivit.Procedura e sistemimit dhe asfaltimit te shtresave rrugore te ketij aksi do te jete sipas kesaj rradhe,do filloje nivelimi i shtreses egzistuese (ne ate pjese qe ekziston) me makineri-greider i cili ben rafshimin dhe germimin ne pjeset anesore te aksit ekzistues ku me kalimin e kohes jane marr grumbullime dherash te cilat kane bllokuar pothuajse teresisht kullimin e ujerave.

Me pas do te behet germimi i kasonetes me thelesi deri 20 cm sipas rastit qe do te verifikohet ne vend ne prani te drejtuesit te projektit(supervizorit).

Pas shtresave asfaltike(binder+asfalt) dhe ngjeshjes se tyre do vijohet ne mbushjen e bankinave me stabilizant me trashesi 10 cm duke i dhene dhe doren perfundimtare te trasese.

Ne degezime apo kthesa do te vijohet ndertimi i shtresave sikunder ne rruge duke i zgjatur ato deri ne distance 10 ml dhe duke ruajtur dhe shtruar me kujdes rakordimet.

Kujdes i vecante do ti kushtohet sinjalistikes si horizontale dhe asaj vertikale sipas projektit.Gjithashtu kontraktori do te kete te bere dhe te zbatoje me perpikmeri rregullimin e trafikut gjate gjithe kohes se ndertimit.

Per rikonstrukcionin e rruges eshte parashikuar qe materialet e ndertimit do te prodhohen me gure kave qe gjendet ne guroret e rrethit.Materiali i asfalto betonit do te vije i gatshem nga nyjet me te aferta.

Te gjitha punimet jane parashikuar te kryhen ne perputhje me specifikimet teknike qe i bashkengjiten ketij projekti.

Preventivi i punimeve eshte dhene per te gjithe rrugen .

Ne preventiv jane parashikuar te gjithe zerat e punimeve sipas specifikimeve teknike te keti projekti, me cmimet e mesatarizuara te tregut, per vitin 2014- 2015.

Per te gjitha zerat e punimeve jane bere analizat e prodhimit dhe vendosjes ne veper ne perputhje me organizimin e punimeve, standartet dhe kushtet teknike ne fuqi.

Bashkengjitur ketij raporti jane dhene; grafiku i punimeve,specifikimet teknike te punimeve, volumet e punimeve ,dhe preventivi perkates.

Situacionimi i ketyre punimeve do te behen mbas verifikimit dhe matjes se punimit ne proces verbalin e vecante qe do te hartohet nga drejtuesi i punimeve , kontraktori dhe drejtuesi teknik i punimeve.

**Punoi:Studio EBS Sh.p.k**

**Ing.Anderson Simoni**

**Ing.Esmeralda Halili**